




Korrik – Tetor 2009



K-MDRI ka arritur të asistojë në punësimin e personave me aftësi të kufizuara mendore.

Si rezultat, 45 persona me aftësi të kufizuara mendore janë të punësuar aktualisht, nga të cilët: 18 janë nga komuna e Prishtinës; 6 nga

Hani i Elezit; 5 nga Kaçaniku; 8 nga Kamenica; 5 nga Peja dhe 3 banorë të Institutit Special në Shtime. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të ndihmojë në trajnimin për punë të personave me aftësi të kufizuara mendore, duke u dhënë mundësinë të krijojnë përvojë praktike në ndërmarrje private dhe publike.

Përmes këtij projekti, K-MDRI ka arritur të dëshmojë që personat me aftësi të kufizuara mendore mund të jetojnë të pavarur, janë në gjendje të punojnë dhe mund të jenë pjesë aktive e shoqërisë. K-MDRI ka realizuar këtë projekt, në bashkëpunim me UNDP, "Skemën për Përkrahjen e Praktikës për Personat me Aftësi të Kufizuara



Mendore", pjesë e Projektit për Tregun Aktiv të Punësimit, të UNDP-së i cili do të përkrahë financimin e pagesës së praktikantëve për dy

muaj.

Projektit të K-MDRI u janë bashkuar edhe studentët nga Departamenti i Pedagogjisë Speciale.



Përveç studentëve të psikologjisë, projektit aktual të K-MDRI u janë bashkangjitur edhe studentët e Departamentit të Pedagogjisë Speciale.

Takimi i parë me studentët e këtij departamenti u organizua më 7 Shtator 2009. Gjatë këtij takimi, studentët e rinj mësuuan për përvojat e studentëve të Psikologjisë, dhe për punën e vetë-avokueses Fatime Berisha, e cila është duke punuar për K-MDRI-në.

Trajnimi për rëndësinë dhe rolin e një Komiteti të pavarur për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore.

Me qëllimin për të informuar dhe trajnuar anëtarët e organizatave Ne për Ne dhe Surviving Together, si dhe pjesëmarrësit e tjerë me aftësi të kufizuara



mendore lidhur me rëndësinë dhe rolin e një Komiteti të pavarur për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore,

K-MDRI ka organizuar një punëtori katërditore. Kjo punëtori u ka ofruar pjesëmarrësve mundësinë për të mësuar nga trajneri Shpend Qamili për kuptimin e Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore duke u prezantuar pjesëmarrësve organe të ngjashme nga pjesë të tjera të botës dhe për mundësinë e themelimit të Komitetit Kosovar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore.

Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësit patën rastin të takojnë personalitete nga organe të ngjashme në Kosovë, të cilët u shpjeguan të pranishmëve funksionimin e komiteteve që ata përfaqësojnë. Të

"Strengthening the Participation of People with Mental Disabilities in Kosovo Society"



An EU funded project managed by the European Commission Liaison Office to Kosovo



A project implemented in association with Mental Disability Rights International [MDRI]

ftuarit në punëtori ishin Afrim Maliqi nga Handikos dhe Bujar Maxhuni nga OSBE.

Punëtorja ishte shoqëruar me prezantime interesante dhe punë në grupe. Nga kjo punëtori përfituan 68 pjesëmarrës. Përfituesit e këtij aktiviteti ishin vetë-avokuesit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikiatrike, personat përkrähës, studentë të Departamenteve të Psikologjisë dhe Pedagogjisë Speciale dhe infermierë.

K-MDRI, Ne për Ne dhe Studentët e Psikologjisë vizituan Institucionet në Shtime.



Stafi i K-MDRI së bashku me vetë-avokuesit e organizatës për dhe nga personat me aftësi të kufizuara intelektuale - Ne për

Ne, dhe studentët e Departamentit të Psikologjisë vazhduan vizitat e tyre mujore në Institutin Special Shtime (ISSH) dhe Qendrën Integruese Shtime (QISH). Qëllimi kryesor i këtyre vizitave është që tu ofrojë vetë-avokuesve dhe studentëve të psikologjisë mundësinë për tu njohur më për së afërmi me banorët e institucioneve, kushtet në të cilat banojnë ata dhe po ashtu, të përkrähin personat me aftësi të kufizuara mendore që të shoqërohen me persona që jetojnë në komunitet. Për shkak se banorët e Institucioneve në Shtime jetojnë për kohë të gjatë aty, ata nuk vizitohen shpesh nga pjesëtarë të komunitetit.

Trajnimi për të Drejtat e Njeriut të Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore dedikuar komunitetit të personave me aftësi të kufizuara mendore.

Me qëllim për të informuar dhe trajnuar komunitetin e personave me aftësi të kufizuara mendore për të Drejtat e Njeriut të Personave me



Aftësi të Kufizuara Mendore, K-MDRI & MDRI organizuan një punëtori katërditore. Punëtorja u organizua me qëllimin që të trajnojë

personat me aftësi të kufizuara psikiatrike dhe komunitetin e personave me aftësi të kufizuara intelektuale lidhur me origjinën e të Drejtave të Njeriut; për të Drejtat e Njeriut të personave me aftësi të kufizuara mendore në Kosovë; dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Përveç kësaj, të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes punës në grup, të punojnë së bashku. Përfitues nga kjo punëtori ishin personat me aftësi të kufizuara mendore të shoqëruar nga studentët e Departamenteve të Psikologjisë dhe të Pedagogjisë Speciale, si dhe personat përkrähës nga Qendra Integruese në Shtime dhe Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj.

Kjo punëtori ishte vlerësuar edhe si shumë e rëndësishme në ngritjen e vetëdijes ndër studentët e Departamenteve të Psikologjisë dhe Pedagogjisë Speciale lidhur me të Drejtat e Njeriut të Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore. Nga kjo punëtori kanë përfituar gjithsej 95 pjesëmarrës, kryesisht persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikiatrike, persona përkrähës dhe studentë Universiteti. Punëtorja është mbajtur në Prishtinë, Qendrën e Resurseve për Personat me Aftësi të Kufizuara, nga 13 deri më 16 Tetor, 2009. Trajner i punëtorisë ka qenë Arta Sadiku, Juriste.

K-MDRI stafi:

Zamira Hyseni Duraku, Drejtor Ekzekutiv

Mjellma Luma, Menaxher i Projekteve

Valid Zhubi, Koordinator i Aktiviteteve

Yllka Buzhala, Asistente e Grupeve Vetë-Avokuese

Qëndrim Jashari, Vetë-Avokues i aftësisë së kufizuar mendore

Fatime Berisha, Vetë-Avokuese e aftësisë së kufizuar mendore

"Strengthening the Participation of People with Mental Disabilities in Kosovo Society"



An EU funded project managed by the European Commission Liaison Office to Kosovo



A project implemented in association with Mental Disability Rights International [MDRI]